



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 421/12 prot.

Tiranë, më 19.9.2025

VENDIM
Nr.34, datë 19.9.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 26, DATË 2.6.2025

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Zbatimin e Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 26, datë 2.6.2025, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në institucionin e Zyrës së administrimit të Basenit Ujor Vjosë, në përbërje të Agjencisë së menaxhimit të Burimeve Ujore, në varësi të Kryeministrit”*,

KONSTATOVA SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni i dërguar me shkresën me nr. 421 prot., datë 1.4.2025, nga nëpunësja Pudrila Haskoçelaj, me detyrë *“Specialiste e Informacionit dhe Inventarizimit të Burimeve Ujore”*, në Zyrën e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në të cilin ngrihen pretendime për parregullsi të lejuara gjatë zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, e konkretisht, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore *“Vërejtje me shkrim”*, në ngarkim të saj.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me këtë informacion, në mbështetje të kompetencave ligjore të sanksionuara në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ka filluar procesin e verifikimit të tij, nëpërmjet shkresës nr. 421/1 prot., datë 11.4.2025, *“Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të ardhur nga nëpunësja Pudrila Haskoçelaj, për dhënie masë disiplinore”*

“Vërejtje””, duke vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure disiplinore, si dhe duke i kërkuar dokumentacionin në të cilin është materializuar ajo.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 26, datë 2.6.2025, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në institucionin e Zyrës së administrimit të Basenit Ujor Vjosë, në përbërje të Agjencisë së menaxhimit të Burimeve Ujore, në varësi të Kryeministrit”*, të Komisionerit.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 26, datë 2.6.2025, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga institucioni, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, konstatohet se situata e administrimit të shërbimit civil paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 1, të vendimit paralajmërues, Komisioneri i ka kërkuar Drejtorit të Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, në zbatim të nenit 108, 110 dhe 111, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, që nëpërmjet një akti të ri me shkrim, të konstatohet pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 114 prot., datë 25.3.2025, për dhënien e masës disiplinore *“Vërejtje me shkrim”*, në ngarkim të nëpunëses Pudrila Haskoçelaj.

Vërej se, me shkresën nr. 397/1 prot., datë 11.09.2025, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 421/10 prot., datë 16.9.2025, Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë ka informuar Komisionerin, duke vënë në dijeni edhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, si dhe Departamentin e Administratës Publike, në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues 26/2025 të Komisionerit.

Konkretisht, me aktin nr. 230/1, datë 19.6.2025, të Drejtorit të Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, është vendosur anulimi i aktit nr.114 prot., datë 25.3.2025, për dhënien e masës disiplinore *“Vërejtje me shkrim”*, në ngarkim të nëpunëses Pudrila Haskoçelaj.

Nisur nga sa më sipër, vlerësoj se, nga ana e institucionit, Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, janë kryer veprimet administrative të nevojshme për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues Nr.26, datë 2.6.2025, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 (i ndryshuar), të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 26, datë 2.6.2025, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të ecursë disiplinore, në institucionin e Zyrës së administrimit të Basenit Ujor Vjosë, në përbërje të Agjencisë së menaxhimit të Burimeve Ujore, në varësi të Kryeministrit”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, duke zbatuar detyrat e lëna të dispozitivit të Vendimit nr.26, datë 2.6.2025.
3. Për këtë vendim të njoftohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha